

## Ministrisë Punëvet Brendëshme

T i r a n ë

Si mbas raportit të Komandës së Grupit të Karabinerisë mbretnore Nr.175/I dt.6 Tetor 1941-XIX ka ndodhë kjo ngjarje:

Dje me dt.5 Tetor drejtori i konviktit t'internatit z.Profesor Stefano Severina Lumba për arsye disiplinore ka pezullue nga shkolla e nga konvikti 3 nxënës të shkollës Normale.Si konsekuencë e kësaj mase rreth orës 19 po t' asaj dite nga 60 konviktors të kurseve të larta pasi kanë shkue në tryezën e ushqimit të gjithë njizanit kanë refuzue me hangë ushqimin e mbramjes tue kërkue me za të natës zhdukjen e masës disiplinore të 3 shokëve të tyre si u tha ma sipër pastaj të gjithë sëbashku kanë lanë sallën e kanë dalë jasht:tue këndue e bartitë në shenjë proteste kundër masës së vendosur prej eprorëve të tyre e mbasi kanë siguruar mbrojen jasht për llogari të tyre kanë shkue për fjetje në lokalin e konviktit. Edhe sot në mëngjez kanë refuzue me ngranë mëngjezin kurse në shkollë kanë shkue e vazhdye mësimet pa dhanë asnjë shenjë kundërshtimi dhe në drekë janë treguar të bindëshëm me ngrënë bukën.

Për të hetue çështjen erdhi Inspektori i Ministrisë së Arësimi Z.Ali Hashorva,i cili ishte i mendimit për marrjen e masave të rënda kundër 2-3 nxënësve që janë fajtorët kryesorë.

ZVPrefekti  
(Rasim Sokoli)d.v.